



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2021:173842

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05625729

C.nr.2021:173843

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.I., me vendbanim në fshatin ..., Komuna e Suharekës, të cilin me autorizim e përfaqëson av Faton Neziraj nga Shtimja, kundër të paditurës Komuna e Shtimes - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, me objekt kontesti kompensimin e tri pagave përcjellëse, vlera e kontestit 1,978.77 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 26 Prill 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh.I..
- II. DETYROHET** e paditura Komuna e Shtimes - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Shtime, që paditësit në emër të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit të i paguaj shumë prej 1,639.93 € (një mijë e gjashtë qind e tridhjetë e nëntë euro, nëntëdhjetë e tre cent), me kamat ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë 05.08.2021 deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 125.00€ (njëqind e njëzet e pesë euro), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. REFUZHET** - Pjesa e kërkesëpadisë me të cilën ka kërkuar që në emër të pagave përcjellëse ti paguhen edhe shuma prej 338.84 euro **si e pabazuar**.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 05.08.2021, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar padi, lidhur me objektin e kontestit kompensimin e tri pagave përcjellëse, kundër të paditurës Komuna e Shtimes - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Shtime.

Në padi ka theksuar se paditësi ka qenë i punësuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Shtime me pozitën e punës Ujë instalues -Vozitës deri më datë 14.06.2021, datë kjo kur me vendim me nr.1.../21 i është ndërprerë marrëdhënia e punës në kuptim të nenit 70, të Ligjit të Punës pas arritjes së moshës së pensionimit. Më tej ka theksuar se kërkesa e tij për pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit e ka bazuar në nenin 17 paragrafi 5 i Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë dhe atë për tri paga mujore që i ka marrë për tre muajt e fundit, e që paditësi në tre muajt e fundit ka pranuar pagë në vlerë 659.59 euro. Të gjithë shumën e aprovuar e ka kërkuar me kamatë ligjore 8%. Andaj ka kërkuar që padia dhe kërkesa e tij të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëse është e pabazuar pasi që kontrata kolektive sektoriale e shëndetësisë e nënshkruar më dt. 11.06.2018 nuk është më në fuqi. Për të gjitha këto arsye pala e paditur ka konsideruar se padia dhe kërkesëpadia nuk kanë bazë ligjore. Andaj i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar dhe kërkesat e parashkruara. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398, të LPK-së për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Ndërsa për pjesën tjetër të kërkesëpadisë, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 399 sipas të cilit “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë

pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë". Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 398, të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, si ujë instalues dhe vozitës në QKMF - Shtime, e që ky fakt gjen edhe mbështetje në Kontratën e punës dhe Vendimin për pensionim.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigjen në padi sa i përket bazës ligjore se Kontrata kolektive sektoriale e shëndetësisë më nuk është në fuqi, Gjykata ka vlerësuar se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Sa i përket çështjes se kontrata kolektive më nuk është në fuqi gjykata morri parasysh faktin se kërkesat sipas padisë rrjedhin për kohën sa kontrata kolektive sektoriale e shëndetësisë ka qenë në fuqi. Rrjedhimisht gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Me qenë se nuk ka qenë kontestuese marrëdhënia e punës dhe shuma e vlerës së kërkesë padisë, Gjykata nuk është lëshuar në analizimin e fakteve të tilla, pasi për palët ndërgjyqës nuk kanë qenë kontestuese.

Nga këto pretendime gjykata ka vlerësuar se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit bazohet në Kontratën Kolektive sektoriale të shëndetësisë 2018 respektivisht nenit 17 par 5 të nënshkruar në mes të Federatave të Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë, është paraparë se „Kompensimi në rast të pensionimit, i punësuarit me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt të fundit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe duke pas parasysh edhe faktet jokontestuese nga palët ndërgjyqës në këtë çështje kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar sikurse në pikën I. dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e paraqitura ka vërtetuar faktin se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura. Lartësia e kërkesëpadisë u mbështet në gjendja e llogarisë bankare e paditësit në të cilën janë të evidentuara tri pagat e muajve të fundit, përmes të cilës u vërtetua shuma se sa është paguar paditësi në emër të tri pagave përcjellëse me rastin e

pensionimit që ishte shuma e tre muajve të fundit sa ka qenë i punësuar andaj edhe shuma e përgjithshme doli të jetë shuma prej 1,639.93€ (e cila del nga llogaritja e thjeshtë nga tri pagat të fundit të pranuar për muajin Prill, paga 617,27€, për muajin maj paga 659,59€ dhe për muajin qershor paga 363,07€, në total shuma = 1639,93 euro).

Gjykata morri parasysh dhe vlerësoi pretendimet e palës së paditur se kërkesat e palëve janë të parashkruara pasi që në kohën e paraqitjes së padisë kontrata kolektive përkatëse nuk ishin më në fuqi edhe pse kontrata kolektive përkatëse nuk ka qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së padisë detyrimet mbeten për kompensimin e pagave përcjellëse me rastin e pensionimit për ditë e punës sa ka qenë kontrata kolektive në fuqi.

Andaj, nga të gjitha të lartcekurat dhe bazuar në dispozitat ligjore të cituara më lartë, gjykata ka vlerësuar se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompensim në pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe se të njëjtat janë të legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e këtij detyrimi nga ana e të paditurit.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar të gjitha pretendimet tjera të palëve ndërgjyqës por ka gjetur se të njëjta janë pa ndikim në zgjidhjen e çështjes ndryshe përtej asaj që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura të Kontratave Kolektive, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar sa i përket shumës së aprovuar ku dhe e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumat e specifikuara në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese për kërkesën e palës përtej shumës së aprovuar të kërkesë padisë, vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, pasi lartësia e kërkesëpadisë u mbështet nga gjendja e llogarisë bankare e paditësit në të cilën janë të evidentuara **tri pagat e muajve të fundit**, përmes të cilës u vërtetua shuma se sa është paguar paditësi në emër të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit që ishte shuma e tri pagave të fundit për muajin Prill paga 617,27€, për muajin maj paga 659,59€ dhe për muajin Qershor paga 363,07€ që rezultoi shuma 1639,93€ euro, andaj edhe shuma e përgjithshme doli të jetë shuma prej 1639,93€ e jo shuma 1978.77 euro si është kërkuar në padi.

Andaj, meqenëse ashtu siç është rregulluar e paditura ka pasur detyrim të paditësit t'ia përfshijë në tri paga me rastin e pensionimit të cilën gjë nuk e ka bërë me rastin e pensionimit, në njërën anë kurse në anën tjetër edhe paditura nuk e ka përmbushur obligimin siç e ka pasur për detyrim sipas Kontratës Kolektive sektoriale të shëndetësisë e datës 11.06.2018 sa i përket pagave me rastin e pensionimit dhe nenit 8, të LMD-së, ku thuhet se “Pjesëmarrësi në marrëdhënie të detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për

përmbushjen e të njëjtit”, e të cilin detyrim e paditura nuk e ka përmbushur ndaj paditësit. Në rastin konkret gjykata i zbatoi dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L/212 ku shprehimisht thuhet “Marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara në marrëveshje te tillë kolektive”.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382, par 1 dhe 2, të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë me datë 05/08/2021 bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020, të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket vendimit mbi shpenzimet e procedurës kontestimore, Gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 452, par 3 dhe nenit 463, të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së cekur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimit, e të cilat shpenzime përfshijnë, përpilimin e padisë në shumën prej 104€, për taksë gjyqësore për padi shumën prej 21 euro, që në shumë të përgjithshme prej 125.00€, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbaramit.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143, nenit 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI CIVIL

C.nr.2021:173843, me datë 26 Prill 2024

Gjyqtari

Faton Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.